

FJALA E DEPUTETIT LAVDRIM KRRASHI

E MËRKURË 9 NËNTOR 2022

Buxheti sot ka detyrën e vështirë për të balancuar dy vështirësi që i kanë jo vetëm ekonomitë e mëdha, por edhe vende të vogla si Shqipëria, si: rritja e çmimeve dhe kriza energjetike. Të dyja së bashku ndikojnë në atë që quhet krizë financiare. Shqipëria është një nga vendet më të mbrojtura, se të vërtetën duhet ta themi ashtu siç është, për shkak të investimeve të mëdha që janë bërë në 10- 15- vjeçarën e fundit në hidrocentrale dhe në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Ne jemi një vend që nuk kemi pasur rritje të çmimeve nga ky këndvështrim, çka ka qenë edhe një faktor kyç për përballimin e vështirësive të kohës që po kalojmë, të inflacionit.

Ndërkohë që këto përpjekje vazhdojnë, madje do të shtoja se do të ishte të mirë të mbahet ky ritëm, sepse nuk është koha për t'u vetëkënaqur. Rrjeti ynë duhet të përballojë jo vetëm nevojat e qytetarëve tanë, por dhe ato kombëtare. Do të ishte e rëndësishme që Shqipëria të jetë e gatshme të vazhdojë të ndihmojë Kosovën, por edhe Maqedoninë e Veriut, edhe Malin e Zi, duke e shndërruar kështu agjencinë tonë energjetike në një superfuqi në Ballkan. Shpresojmë që një ditë të jetë e gatshme të konkurrojë edhe me kompanitë europiane të energjetikës, kur ne të jemi vend anëtar i BE-së.

Në kuadër edhe të angazhimeve të Shqipërisë kundër ndryshimeve klimaterike, si pjesë e marrëveshjeve ndërkombëtare, është koha më e mirë për të investuar në këtë sektor. Jam i lumtur që qeveria ka rritur investimet në ujësjellës, duke risjellë në qendër të vëmendjes një tjetër dobishmëri kombëtare. Do të marr si shembull qarkun tim, qarkun e Dibrës, ku përveç ujësjellësit të sapoinauguruar të Peshkopisë, në projektbuxhetin e vitit 2023 janë edhe disa plane të tjera, duke filluar nga qyteti i Burrelit apo fshatra të ndryshme të Matit, në Luzninë e Peshkopisë apo në Derjan të Matit apo burime të tjera.

Për vitin 2023 vazhdon financimi i projekteve ekzistuese, sidomos për atë që ne në Dibër, në Peshkopi i referohemi si përroi i llixhave apo "Përroi i shërimit", për segmentin Ura e Pazarit-Llixha apo për rikualifikimin urban të krejt qytetit, që ka filluar tashmë.

Edhe në këtë program buxhetor, pjesa më e madhe e fondeve shkon për financimin e projekteve ekzistuese, pra atyre në vazhdim, megjithatë gjatë vitit 2023 janë parashikuar edhe disa projekte të reja, në fakt pak, ku vlerën më të madhe do ta zërë projekti i ndërtimit të ujësjellësit në Mat, me një vlerë rreth 102 milionë lekë. Ky buxhet sheh rritje të totalit të investimeve në qarkun tim të Dibrës, krahasuar

me vitin e kaluar, kryesisht si rezultat i vazhdimit të investimit në Rrugën së Arbrit, por shpresoj që investimet të vazhdojnë edhe në sektorë të tjerë, në mbështetje të biznesit, por dhe për rishikimin e algoritmit për shpërndarjen e granteve qeveritare ndaj autoriteteve lokale apo bashkive, në mënyrë që ato të kenë mundësi për të pasur qendra për të rinj apo mbështetja për njerëzit në nevojë të jetë më e madhe.

Qarku i Dibrës është nga më të impaktuarit nga emigracioni dhe është parësore që autoritetet lokale, bashkitë të kenë fondet e nevojshme për rritjen e mundësive për të rinjtë, që ata të punësohen në vendin tonë.

Do të doja të merrja një moment sot për të diskutuar për disa nga komentet që vijnë prej qeverisë, por edhe prej medias britanike për numrin në rritje të bashkëqytetarëve, bashkëkombësve tanë që u janë drejtuar brigjeve britanike. Pa u ndalur shumë te kjo, se jam i bindur që këto komente janë edhe për konsum të brendshëm politik këtej dhe andej kufirit, dua të them se janë të mirëpritura deklaratat e fundit të përfaqësuesit të shtetit britanik, të ambasadorit, i cili dënon disa prej komenteve të bëra në ato që quhen “fletushka” në tregun mediatik britanik. Bashkëpunimi ynë me Mbretërinë e Bashkuar ka qenë gjithmonë aktiv, vazhdon të jetë dhe ne jemi të angazhuar ta rrisim atë më tej.

Unë, por edhe shumë kolegë të mi u kemi bërë jehonë këtyre komenteve para disa ditësh dhe në vazhdim jo vetëm në mediet shqiptare, por edhe në BBC-i, ITV, Sky News, që janë mediet kryesore në Mbretërinë e Bashkuar. Ky Kuvend duhet të jetë gjithmonë i gatshëm për të mbrojtur reputacionin dhe të drejtat e qytetarëve shqiptarë që jetojnë në Mbretërinë e Bashkuar. Unë nga kjo foltore mund të them se jemi shumë krenarë për komunitetin shqiptar jo vetëm në Mbretërinë e Bashkuar, por kudo tjetër. I duam fort dhe i mbështesim shumë.

Në këtë kuadër, dua të them se është e rëndësishme të vazhdojnë përpjekjet tona për të krijuar profesionistë në vendin tonë, në Shqipëri. Sigurisht, disa prej tyre do të zgjedhin të marrin përvojë jashtë vendit, të mësojnë një gjuhë të huaj, të udhëtojnë dhe të njihen me kultura të ndryshme, por ne duhet që gjithmonë t'i bëjmë ata të ndihen të mikpritur për t'u kthyer në çdo kohë, që të drejtat e tyre janë të patjetërsueshme për ta dhe për fëmijët e tyre, kudo që ata jetojnë.

Ndaj unë dua të vlerësoj investimet që parashikon projektbuxheti për arsimin. Në projektbuxhetin e vitit 2023 janë parashikuar disa investime për qarkun e Dibrës, ku do të veçoja rikonstruksionin e plotë të shkollës së mesme profesionale “Nazmi Rushiti” në Peshkopi apo në disa shkolla që shtrihen në të gjithë qarkun.

Së fundi, jo nga rëndësia, ne kemi vazhduar punën tonë në parlament, natyrshëm edhe qeveria, por është koha për të dalë përtej fjalëve, e drejta që qytetarët shqiptarë kudo që jetojnë të marrin pjesë në vendimmarrjen politike në Shqipëri, nuk mund të shtyhet më. Qytetarët shqiptarë duhet të kenë të drejtën e votës, që ta hedhin atë në vendin ku ata kanë zgjedhur për të jetuar dhe për të punuar. Në këtë kuptim, patjetër që parlamenti ka rolin kryesor edhe të kërkesës së llogarisë ndaj të gjitha institucioneve: Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë apo KQZ-së.

Faleminderit!